



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 67, Datë 08.04.2020

MBI

**PEZULLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË FSHU SH.A.
PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES ME PAKICË PËR KLIENTËT QË
SHËRBEHEN NGA FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR VITIN 2020 DHE
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE SIPAS NIVELIT TË
TENSIONIT PËR VITIN 2020.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, gërma “c”, nenit 85 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, VKM nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, nenit 67 dhe 91 pika 4 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenit 15 dhe 22 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE- s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.04.2020 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore, “Mbi pezullimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020 dhe shqyrtimin e aplikimit të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020.

Konstatoi se:

- Me vendimin nr.2 datë 10.01.2020, Bordi I ERE ka vendosur për fillimin e procedurës “Për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020 dhe shqyrtimin e aplikimit të operatorit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020.
- ERE ka vijuar procesin e saj të komunikimit zyrtar me aplikuesit me qëllim marrjen e shpjegimeve për çështjet e trajtuara në korespondencat e deritanishme mbi këto aplikime të cilat janë gjykuar të nevojshme për tu plotësuar më tej me sqarime përkatëse si dhe

ka kryer një sërë seancash konsultimi me një spektër të gjërë të palëve të interesit dhe përfaqësuesve të FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a.

- Së fundmi me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.3.2020 është vendosur për:
 1. *Shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID*
 2. *Kufizimin e të drejtave të garantuara nga nenet 37, 38, 41, pika 4, 49 dhe 51 të Kushtetutës deri në masën që konsiderohet e domosdoshme për të arritur ruajtjen e shëndetit të shtetasve.*
- Mes të tjerash në këtë vendim është vendosur detyrimi për Institucionet publike që:
 - *d) të kufizojnë aksesin në ambiente publike, të cilat kanë një frekuentim të gjerë*
 - *e) të kufizojnë aktivitetet në minimumin e domosdoshëm për të gjitha organet publikë*
- Në Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE në nenin 22 parashikohet se *si rregull gjatë shqyrtimit të aplikimit ERE-ja organizon seanca dëgjimore teknike me aplikuesin, si dhe në çdo rast zhvillon seanca dëgjimore publike sipas rregullave për zhvillimin e seancave dëgjimore.*
- Me shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore, janë kufizuar një sërë lirisht kushtetuese e mes të tjerave është kufizuar aksesin në ambiente publike, të cilat kanë një frekuentim të gjerë, tubimet, etj, dhe për Institucionet publike edhe aktivitetet në minimumin e domosdoshëm.
- Me marrjen e këtyre masave të jashtëzakonshme, ERE ndodhet në kushtet e pamundësisë për të organizuar seanca publike apo teknike si dhe për të vijuar normalisht procesin e konsultimit me të licencuarit apo me aplikuesit si dhe palët e interesit
- Me shpalljen e gjëndjes së jashtëzakonshme, kufizimin e lirisë së lëvizjes si dhe grumbullimit të personave përtej orareve të lejuara në kuptim të legjislacionit të miratuar rishtazi me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ndaj infeksionit Covid 19, pamundësohet vijimi i procesit të konsultimit me, dhe nga palët e interesit.
- Me pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore me anë të vendimit nr. 127, datë 10.03.2020 dhe vendimin nr.128, datë 24.03.2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për të gjitha gjykata e vendit, të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, për shkak të situatës së krijuar nga infeksioni Covid 19, vështirësohet ushtrimi i së drejtës që cdo palë e interesit mund të ketë për të kërkuar rishikimin e vendimit të ERE për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020 dhe për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020.
- Kodi i procedurës administrative në nenin 67, parashikon se: *Organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.*

- Gjatë vitit 2020, Furnizuesi i Shërbimit Universal FSHU sh.a si dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a., do të vijojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre me tarifa të rregulluara, si më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi të ERE-s,

Vendosi:

1. Pezullimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU sh.a për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020 dhe shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020, deri jo më vonë se 3 muaj nga përfundimi I gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit në lidhje me vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI